



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave, 01-Nr.110-247315, të datës: 03.10.2016 dhe në përputhje me pikën 11.1 të Kontratës "Kontratë në shtëpi" të lidhur në mes Komunës së Prishtinës dhe Ndërmarrjes KRM "Pastrimi" me numër: 14-024/01-26117/23, të datës: 03.02.2023, Drejtoria e Shërbimeve Publike merr këtë:

## V E N D I M

I. Obligohen të gjithë personat fizik dhe juridik që posedojnë pronë të paluajtshme (rezidenciale, komerciale dhe industriale), në territorin e komunës së Prishtinës, të cilët nuk kanë regjistruar pronat e tyre në regjistrat e amvisërive dhe bizneseve, lidhur me taksën komunale për grumbullimin e mbeturinave, që të regjistrojnë pronën e tyre brenda nëntëdhjetë (90) ditëve kalendarike, pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

II. Obligohen inkasantët dhe zyrtarët e tjerë përgjegjës të ndërmarrjes KRM "Pastrimi", që të regjistrojnë dhe të verifikojnë të gjitha të dhënat dhe informacionet e nevojshme, për të gjitha pronat e paluajtshme rezidenciale, komerciale dhe industriale, si dhe konsumatorët e regjistrimit (databazës) ekzistuese të menaxhimit të mbeturinave, përkatësisht regjistrimit lidhur me taksën e grumbullimit të mbeturinave për amvisëri dhe biznese, në territorin e komunës së Prishtinës, në bashkëpunim me Sektorin e Tatimit në Pronë.

III. Obligohen të gjithë personat fizik dhe juridik, të cilët kanë në pronësi ose posedojnë pronë të paluajtshme, të bashkëpunojnë me personat e autorizuar të ndërmarrjes KRM "Pastrimi" dhe përfaqësuesit e komunës së Prishtinës dhe t'ua mundësojnë qasjen/hyrjen në pronat e tyre, në mënyrë që të mbledhin informacionet e nevojshme lidhur me pronën e paluajtshme dhe pronarin e saj.

IV. Obligohen ndërmarrja KRM "Pastrimi" dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, si organ publik, që gjatë përpunimit të të dhënave personale të personave fizik dhe çdo informacioni tjetër të personave juridik, që këto të dhëna t'i ruajnë nën konfidencialitet të plotë dhe t'i përdorin vetëm me qëllim të menaxhimit të regjistrimit (databazës) së amvisërive dhe bizneseve lidhur me taksën e grumbullimit të mbeturinave dhe në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.



V. Me qëllim të administrimit sa më të mirë të procesit të menaxhimit të regjistrit (databazës) së amvisërive dhe bizneseve lidhur me taksën e grumbullimit të mbeturinave, Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit, në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike si bartës i këtij procesi, do të bashkëpunojë dhe shkëmbej informacione me të gjitha drejtoritë e tjera të komunës së Prishtinës, e në veçanti me Sektorin e Tatimit në Pronë dhe organet e tjera që kanë në administrim ose disponojnë informacionin e nevojshëm lidhur me amvisëritë dhe bizneset, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara me kontratën "*Kontratë në Shtëpi*" të lidhur në mes Komunës së Prishtinës dhe Ndërmarrjes KRM "Pastrimi" me numër: 14-024/01-26117/23, të datës: 03.02.2023.

## A r s y e t i m

Komuna e Prishtinës me qëllim të menaxhimit sa më të mirë të regjistrit (databazës) lidhur me taksën e grumbullimit të mbeturinave dhe me qëllim që të gjithë qytetarët dhe bizneset, të përfshihen në ofrimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave në gjithë territorin e komunës së Prishtinës, ka vendosur që të nënshkruaj kontratën: "*Kontratë në shtëpi*" me ndërmarrjen KRM "Pastrimi".

Për të realizuar një synim të tillë, Komuna e Prishtinës ka marrë vendim që ky proces të realizohet nga ndërmarrja KRM "Pastrimi" nën mbikëqyrjen e Sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë përkatëse komunale, të cilat posedojnë të dhëna që mund të ndihmojnë në këtë proces, në mënyrë që asnjë qytetar dhe asnjë biznes, të mos mbetet pa përfituar shërbimin e grumbullimit të mbeturinave.

Me këtë rast, Drejtoria e Shërbimeve Publike, përkatësisht Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit, mund të kërkojë të dhëna edhe nga përfaqësitë dhe konsullatat e akredituara në Kosovë, si dhe të gjitha Organizatat e tjera ndërkombëtare, që kanë në pronësi ose shfrytëzojnë prona të paluajtshme, me qëllim të përfshirjes së tyre në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave dhe aplikimit të taksës së grumbullimit të mbeturinave.

Andaj, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, bazuar në Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave, 01-Nr.110-247315, të datës: 03.10.2016 dhe në përputhje me pikën 11.1 të Kontratës "*Kontratë në shtëpi*" të lidhur në mes Komunës së Prishtinës dhe Ndërmarrjes KRM "Pastrimi" me numër: 14-024/01-26117/23, të datës: 03.02.2023, Drejtoria e Shërbimeve Publike, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të Vendimit.

**Ilirik Mustur**

Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike



**Prishtinë,**

**01.03.2023**

